

KOÇO BIHIKU

**MBI DISA DETYRA TË SHKRIMTARËVE DHE TË KRITIKËVE
PËR NORMATIVIZIMIN DHE PËRSOSJEN E MËTEJSHME
TË GJUHËS SONË LETRARE**

Projekti i drejtshkrimit, i plotësuar me vërejtjet e vlefshme që janë bërë gjatë diskutimit në këto pesë vjet dhe me ato që do të bëhen në Kongresin tonë, pa dyshim, do të ndihmojë në vendosjen e normave të përcaktuara e të njësuar letrare dhe në ngritjen e mëtejshme të kulturës të shkruarit. Por, nuk do të ishte e drejtë të mendohej se me miratimin e variantit përfundimtar të rregullave të drejtshkrimit, merr fund çështja e normativizimit të gjuhës letrare. Kongresi do t'u japë punonjësve të frontit të kulturës drejtshkrimin përfundimtar, i cili do të shërbejë si bazë për ta vazhduar më me ngulm luftën për ngulitjen dhe zotërimin e normës së njësuar, për pasurimin dhe përsosjen e gjuhës letrare. Në punë të normativizimit dhe të përsosjes së mëtejshme të gjuhës një rol të rëndësishëm do të luajë në të ardhmen letërsia artistike, sepse gjuha e veprave letrare zë një vend të veçantë në gjirin e gjuhës letrare kombëtare; ajo është një nga format e ekzistencës së gjuhës letrare. Shkrimtarët mbështeten në normën letrare dhe japin dorë për përhapjen e saj dhe për përsosjen në përgjithësi të gjuhës letrare kombëtare.

Dihet se në zhvillimin e gjuhës sonë letrare të periudhës së fundit, një kontribut të rëndësishëm ka dhënë letërsia jonë. Mendimi se në këtë çerek shekulli, që zë fill pas vendosjes së pushtetit popullor e vjen deri në ditët tona, letërsia nuk ka qenë faktor aktiv në zhvillimin e gjuhës letrare, mbështetet në një përfytyrim të njëanshëm dhe të pasaktë të proceseve që u shtollën në gjirin e saj pas çlirimit. Pa dyshim, në historinë e gjuhës letrare në këto dy dhjetëvjeçarët e fundit, kryesore ka qenë afirmimi përfundimtar i normës letrare të njësuar kombëtare. Publicistika ka dhënë kontributin e vet me vlerë në fiksimin dhe kristalizimin e normës letrare. E lindur në zjarrin e luftës për shkatërrimin e rendit të vjetër politik e shoqëror dhe ndërtimin e Shqipërisë së re, publicistika nuk mund të mos merrte parasysh tendencat e reja që u shfaqën në zhvillimin e gjuhës letrare në vitet e revolucionit popullor. Për një varg shkaqesh të karakterit gjuhësor dhe shoqëror-politik, publicistika e pati më të lehtë që të kapërcejë dualizimin që ekzistonte në gjuhën letrare të paraçlirimit dhe si rrjedhim të luajë një rol më aktiv në procesin e normativizimit të gjuhës. Kurse në letërsinë artistike për një kohë të gjatë u përdorën dy variantet e gjuhës letrare, çka nuk mund të mos pengonte kristalizimin e normës së njësuar në veprat letrare, sadoqë në të mbizotë-

roi në mënyrë të plotë gjuha letrare e ngritur mbi bazën e koinesë së të folmeve të jugut. Mirëpo në gjuhën letrare nuk pati vetëm ndryshime që u përcaktuan nga procese të karakterit normativizues. Në zhvillimin gjuhësor të periudhës së pasçlirimit u zhvilluan edhe ndryshime të tjera jo më pak të rëndësishme, si pasurimi në disa drejtime i fondit leksikor të gjuhës, zgjerimi i mjeteve të shprehjes. Sigurisht, edhe në këtë pikë publicistika ka lojtur rolin e vet; ajo ka ndihmuar për pasurimin e fondit të gjuhës me fjalë dhe terma të sferës politike-shoqërore, të cilat ose u morën nga leksiku ndërkombëtar, ose u ndërtuan mbi bazën e shqipes me mjetet fjalëformuese të gjuhës së shkruar. Por në të njëjtën kohë në publicistikë hynë edhe shumë fjalë, konstrukte dhe shprehje frazeologjike me prejardhje të huaj. Vetëm nga viti 1965 gjuha e publicistikës nis të mbështetet më shumë në pasurimin e gjuhës së folur të popullit. Rritja e rolit të masave në jetën e vendit në periudhën e thellimit të mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kultural, dalja e tyre më shpesh me shkrime (artikuj, letra etj.) në faqet e gazetave etj., aktivizimi më i madh i korrespondetëve vullnetarë, numri i të cilëve u shtua shumë në këto vite, me një fjalë rritja e rolit të masave në shtyp, bëri që gjuha e publicistikës të afrohet me ligjërimin popullor-bisedor dhe të pasurohet me fjalë dhe mjete shprehjeje të gjuhës së gjallë të popullit.

Ndryshe nga publicistika, letërsia ka dhënë kontribut të madh në përpjekjet që nisën që pas çlirimit për të zbuluar pasuritë e pashtershme të gjuhës sonë amtare. Në vitet e pushtetit popullor gjuha e letërsisë artistike u bë më e pasur; në të u përfshinë shumë fjalë, forma dhe shprehje nga ligjërimi popullor bisedor. Kjo ndikoi pozitivisht në pasurimin e mjeteve të shprehjes të letërsisë artistike; rëndësia e këtij fakti bëhet edhe më e qartë po të kemi parasysh intelektualizimin që përfshiu në vitet 30 jo vetëm formën e shkruar të gjuhës letrare, por edhe atë të folur. Në vitet 30 në shtyp, në botime të ndryshme etj. u ngushtua shumë sfera e përdorimit të ligjërimin popullor-bisedor, i cili nuk njihej si kategori e veçantë e normës letrare. Kjo dukuri preku edhe veprat e një varg autorëve të rinj të kësaj periudhe, gjuha e të cilëve ndërtohej kryesisht mbi elementet e stilit libror, gjë që nuk mund të mos çonte në varfërimin e mjeteve të shprehjes letrare.

Pas çlirimit gjendja ndryshoi në drejtim të kundërt. Gjuha e letërsisë artistike nisi të përvetësojë fjalë, forma dhe shprehje të shumta të ligjërimin popullor-bisedor. Në këtë gjë ndikoi shumë ndryshimi i përbërjes së inteligjencës, në këtë mes dhe i asaj krijuese artistike. Shkrimtarët që vinin nga shtresat e gjëra të popullit, futën në gjuhën letrare shumë elemente të shprehjeve të të folurit të tyre, sidomos në fushën e fjalorit. Më të shumtën e herës këto ishin fjalë nga ligjërimi i thjeshtë i përditshëm, fjalë dhe shprehje popullore, që, ndonëse në fillim i përkisnin së folmes krahinore që përdornin shkrimtarët, dalëngadalë u rrënjosën në gjuhën letrare, duke marrë me kohë vlerën e normës.

Procesi i depërtimit në shkallë të gjerë i elementeve të shtresave të tjera gjuhësore, në gjuhën e letërsisë artistike u bë në të gjitha gjinitë letrare, si në poezi, ashtu edhe në prozë. Në poezi ky proces ishte më i dukshëm dhe më i kapshëm. Në këtë fushë të krijimtarisë letrare

ekzistonte një gjuhë e veçantë, e përbërë nga fjalë, forma dhe shprehje, të cilat për nga veçoritë e tyre stilistike formonin diçka të qëndrueshme dhe të veçuar brënda gjuhës së veprave artistike. Për nga tradita «gjuha poetike» lidhej me lirikën qytetare të periudhës së Rilindies kombëtare, e cila karakterizohej nga përdorimi i një shtrese të caktuar të mjeteve gjuhësore për të krijuar hov lirik dhe tension emocional. Disa nga fjalët dhe shprehjet e kësaj gjuhe poetike ishin kthyer në klishe poetike pa vlerë ose në trope të leckosura nga përdorimi pa masë.

Duke nisur nga fundi i viteve 50, poezia shqipe kapërceu në zhvillimin e vet karakterin e mbyllur të gjuhës poetike dhe hoqi dorë nga përdorimi i fjalëve të veçanta poetike si diçka që binte në ndesh me kërkesat e kohës. Poetët e rinj e kuptuan se fjalët poetike dhe togjet e saj frazeologjike nuk ishin të domosdoshme në punën krijuese poetike; ato përbënin një shtresë leksikore që nuk u hynte në punë në përpjekjet që po bënin për një pasqyrim sa më të gjërë e më të gjithanshëm të jetës së shoqërisë së re. Me veprat poetike të I. Kadaresë, D. Agollit, A. Shehut, Dh. Qiriazit, F. Arapit etj. u shemb përdhe sistemi i mbyllur i gjuhës poetike, që ekzistonte më parë, dhe ju hap rruga në poezi fjalëve dhe shprehjeve të zakonshme nga sfera e jetës së përditshme dhe nga ligjërimi popullor-bisedor, të cilat si fakte të gjuhës u bënë tipare të reja, specifike të gjuhës së poezisë së sotme. Në një shkallë më të vogël ky proces u zhvillua edhe në prozë. Hyrja në veprat letrare e heronjve që mishërojnë përfaqësuesit e krahinave dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, nevoja për t'i karakterizuar ata me anë të ligjëritimit bisedor dhe për t'i përshkruar në ambientin e tyre konkret jetësor, bënë që prozatorët t'u drejtohen shtresave të tilla të gjuhës, si dialektizmave, provincializmave dhe ligjëritimit të përditshëm. Kjo është në përputhje me prirjen e përgjithshme të gjuhës letrare, e cila i bën pronë të saj gjithë mjetet gjuhësore që i duhen pavarësisht nga burimi dialektor.

Por duke vënë në pah me të drejtë kontributin e çmuar të letërsisë sonë artistike në zhvillimin e gjuhës shqipe letrare, duhet theksuar se në të ardhmen ky rol do të jetë edhe më i madh. Krahas pasurimit të gjuhës letrare me fjalë dhe shprehje frazeologjike, të huazuara nga gjuha e gjallë e popullit, prirje kjo që nuk e humbet rëndësinë e vet edhe në vitet e ardhme, kontributi i letërsisë artistike do të jetë më tepër, siç duket, në drejtim të ngulitjes së mëtejshme të normës letrare dhe në përgjithësi të përsosjes së mëtejshme të gjuhës letrare.

Dihet se puna e shkrimtarit me gjuhën e veprave të veta nuk është çështje e veçantë, vetjake, por një punë me rëndësi të përgjithshme, popullore. Me daljen në dritë të veprës, gjuha e shkrimtarit bëhet pronë e atyre që e lexojnë, pronë e gjithë popullit. Duke qenë se në veprat artistike del në shesh karakteri real i normës letrare, rëndësi të madhe ka qëndrimi i shkrimtarit ndaj kësaj norme. Përgjegjësia e shkrimtarit për gjuhën e tij është e madhe edhe për shkak të rolit të gjerë veprues të letërsisë artistike, si një nga llojet e artit më popullor, më i kuptueshëm dhe më i përhapur. Nga shkalla e respektimit të normës letrare në veprat artistike varet edhe përhapja e zotërimi i saj nga masat e gjera të popullit. Lidhur me rritjen e ndikimit të veprave letrare në

procesin e normativizimit dhe të përsosjes së mëtejshme të gjuhës shqipe, dalin një varg problemesh.

Një nga problemet më të rëndësishme është, sipas nesh, përdorimi i tepëruar dhe pa vend i dialektizmave, provincializmave etj., dukuri që vihet re shpesh në gjuhën e letërsisë artistike. Në një varg veprash të sotme letrare autorët përdorin pa kriter e pa nevojë në ligjërimin e tyre një mori fjalësh e shprehjesh dialektore: *firomë* në vend të frymës, *kaptoj* në vend të kapërcej, *ferk* në vend të ndryshimit, *dallimit*, *firifickë*, *kukutiçkë*, *çirmë*, *i drobolitur*, *buja*, *norie*, *neqëze*, *usia*, *vrijon*, *franjëz*, *mbllaqe*, *pllashtirë* etj. Ndodh që ndonjë shkrimtar, në vend që të përdorë fjalën që ka zënë vend në gjuhën letrare si normë, priret nga varianti dialektor i saj, kështu p.sh. disa shkrimtarë përdorin *mëlmit* për mërmërit, *roposh* për përposh, *lirmë* për lirshëm, *tërmonë* për gjithë vitin, *inatçor* për inatçi, *i lemerosur* për i lemerisur, *vendarak* për vendas etj. Ndonjëherë gjejmë në veprat letrare edhe frazeologjizma me përdorim të ngushtë dialektor që nuk sjellin ndonjë pasurim në krahasim me shprehjet më të përgjithshme të ngulitura, si: *morën udhën e madhe*, *qiti kushtrimin*, *qiti kryet* etj.

Kuptohet se ky shpërdorim i fjalëve, i formave dhe i shprehjeve krahinore është, ndër të tjera, pasojë e vetë gjendjes së sotme akoma të papërpunuar plotësisht të stilit të letërsisë artistike, ku nuk mund të flitet akoma për kritere dhe kufij të përdorimit të domosdoshëm dhe të përligjur të shtresave leksikore, që qëndrojnë jashtë normës letrare. Por, duke shfrytëzuar përvojën e arritur me intuitë dhe duke pasur shijen e duhur të gjuhës, shkrimtari mund t'u shpëtojë gabimeve të llojit që përmendëm më sipër. E kemi fjalën për gjuhën e shkrimtarëve e jo për gjuhën e personazheve, ku fjalët dhe shprehjet dialektore përligjen nga pikëpamja estetike, shërbejnë për karakterizimin dhe individualizimin e personazheve që mishërojnë përfaqësuesit e grupeve të ndryshme shoqërore dhe krahinave të ndryshme. Dialektizmat, provincializmat etj. mund të përdoren gjithashtu edhe në disa raste kur rrëfimi bëhet në vetë të parë ose kur autori për qëllime të caktuara estetike e stilizon me vetëdijë gjuhën e vet në frymë të gjuhës së përrallave popullore ose e ndërton tërësisht mbi bazën e ligjërimin popullor-bisedor dhe të fakteve gjuhësore që dalin jashtë normës letrare.

Futja pa kriter e dialektizmave në veprat letrare pengon ngulitjen dhe zotërimin e normës letrare nga shtresat e gjera të lexuesve dhe ngadalëson ngritjen e nivelit të kulturës së tyre të gjuhës. Por duke iu rreshtur fjalëve, formave dhe shprehjeve të ngushta dialektore, shkrimtarët nuk duhet të heqin dorë aspak në ligjërimin e tyre nga shfrytëzimi i gjuhës së popullit, e cila është plot me mjete të bukura dhe të gjalla shprehëse.

Problemi tjetër që del lidhur me ngritjen e mëtejshme të rolit të letërsisë artistike në përsosjen e gjuhës letrare, problem për të cilin është folur dhe shkruar në shtypin tonë, janë mbeturinat e një stili retorik e pseudoromantik, plot «lulka» dhe «ojna».

Ja disa shembuj të një stili të kërkuar dhe jo të natyrshëm: «Dy re të vogla të lehta e të holla si tyl, shkisinin ngadalë duke ju afruar njëra-tjetrës sikur të kishin lënë pikëpjekje për t'u takuar».

Në një vend tjetër lexojmë: «U tremb nga zëri i tij. Dhe sytë i çeli.

Para saj pa djaloshin t'i buzëqeshte. Dhe sa shpejt ju ulën pëlhurat e zeza të shqetësimit nga katartet e kujtimeve të saj! Dhe si ato sorkadhët e lehta, që brofin më këmbë, e tundin nga dy herë kryet e shikojnë larg pa lëvizur qepallat, ashtu edhe vajza brofi më këmbë, tundi nga dy herë kryet e saj mbi atë qafëz pak të gjatë, duke dashur të hidhte prapa flokët e saja të çpleksura, dhe sytë i nguli në det, pak si vëngër, pa lëvizur qepallat e gjata». Mendoj se përdorimit të shprehjeve të tilla si «pëlhurat e zeza të shqetësimit» ose krahasimit të vajzës me «sorkadhën e lehtë e me qepalla të gjata», tashmë u ka kaluar koha; ato, në vend që ta gjallërojnë përshkrimin, fusin në veprat letrare një frymë manierizmi.

Ndonjëherë prirja për ta bërë përshkrimin sa më të «bukur», ka çuar në atë që lexuesi të mos i besojë shumë asaj që thotë autori. Një efekt të kundërt me ato që kërkon të arrijë shkrimtari bën p.sh. ky përshkrim, i cili tingëllon shumë i kërkuar: «Kur shikonte djalin që buzëqeshte si dita plot diell, si deti i kaltër mbi të cilin kërcente fryma e lehtë e mistralit, i bëhej sikur ai i hidhte dritën me elektrikun e dorës dhe i tregonte një shteg tjetër, ku ëndërrat s'kanë kufi».

Ndonjëherë zelli i madh për ta zbukuruar me sa më shumë *lulka* gjuhën, e bën përshkrimin banal. Kështu, p.sh. fraza «... unë i gjori i flisnja me gjuhë që dukej se lëpinte lumturinë», megjithëse e vënë në gojën e personazhit, tingëllon vulgare.

Zotësia e artistit të fjalës qëndron në atë që të gjejë në gjuhë ato fjalë dhe shprehje që japin drejt dukurinë ose veprimin që përshkruhet dhe që zhvillojnë shije estetike të shëndosha.

Së fundi, problemi tek i cili mendoj se duhet të ndalet vëmendja e shkrimtarëve dhe e kritikëve është përdorimi jo i saktë i fjalëve, shkëputja e fjalës nga objekti, zhveshja e fjalës nga kuptimi i saj themelor sendor.

Në romanin e një autori, që shquhet për zell dhe kujdes në punë të gjuhës, lexojmë: «Vajza mend shpërthente nga lumturia. Asaj sikur t'i këndonin dhe sytë edhe mollzat e faqeve». Që njeriut zakonisht i ndrisin sytë nga gëzimi; kjo kuptohet, por se mund t'i këndojnë edhe mollëzat e faqeve, kjo është e vështirë të përfytyrohet.

I pasaktë dhe madje i kërkuar është edhe ky përshkrim: «Ajo dëgjoi një këngë që po fërshëlohej përmes një palë dhëmbëve të shtrënguar që kërcisnin si shega në degë».

Një autor i ri, duke mos i vënë kujdes fjalës, që është materiali i punës së tij, shkruan: «Akrepat trokisnin me një zhurmë që sa vinte e bëhej më e tmerrshme». Kur lexon këto rradhë, habitesh për durimin e njerëzve, të cilët lejojnë që akrepat tek u tregojnë kohën, t'u prishin qetësinë me zhurmën e tmerrshme që nxirrkan. Por pakujdesi në ndërtimin e frazës gjejmë edhe tek autorë, me përvojë të gjatë në fushën e letrave. Një shkrimtar i njohur shkruan: «Tetua... me vështrimet e saj të shpejta e hetonjëse s'bëri zë», duke marrë me sa duket, shprehjen e njohur *edhe sytë flasin* në kuptimin e saj të mirëfilltë, d.m.th. deri sa flasin sytë, ato duhet të nxjerrin pa tjetër edhe zë.

Rastet e qëndrimit jo të kujdesshëm dhe me dashuri ndaj gjuhës nuk janë të pakta. Kjo tregon se jo të gjithë shkrimtarët e ndjejnë në shkallë të barabartë përgjegjësinë e tyre për saktësinë e gjuhës, për

ngritjen e forcës së saj shprehëse. Është plotësisht i drejtë mendimi i shkrimtarit D. Agollit, i cili në një artikull të tij mbi problemet e gjuhës së letërsisë sonë artistike ka thënë: «Megjithë evoluimin e madh të gjuhës artistike në prozën tonë, përsëri ndjehet nevoja e një koloriti më të madh, e një saktësie më rigoroze, e një disiplinimi më të shëndoshë».

Por duke vënë në dukje përgjegjësinë e shkrimtarëve për pasurimin dhe përsosjen e gjuhës sonë letrare, s'duhet të harrojmë se edhe kritika letrare nuk e ka kryer si duhet misionin e vet në këtë drejtim. Ajo di të analizojë veprat nga pikëpamja e brendisë, të zbulojë rolin e tyre në edukimin ideor të njerëzve, por pak merret me formën e krijimeve letrare dhe me një nga elementet kryesore të saj — gjuhën artistike. Zakonisht në artikujt dhe recensionet për veprat letrare çështjet e formës përmenden në fund me dy-tri fjalë, sa për të larë gojën. Kuptohet, se kjo gjendje është krejt e pakënaqshme. Kritika duhet të tregojë më shumë vëmendje për problemet e mjeshtërisë artistike të shkrimtarëve tanë, të nxjerrë në dukje rolin e tyre në normativizimin, pasurimin dhe përsosjen e gjuhës letrare, t'i luftojë cenet dhe gabimet gjuhësore dhe stilistike me karakter të përgjithshëm. Kritika jonë letrare duhet të ndihmojë më shumë letërsinë tonë të realizmit socialist të kryejë sa më mirë rolin e saj si përçuese e normës letrare dhe në të njëjtën kohë të përhapë në masat pasurinë e madhe të mjeteve të shprehjes të gjuhës shqipe letrare kombëtare.

Këto do të ishin, sipas nesh, disa nga problemet që i dalin përpara letërsisë dhe kritikës letrare në përpjekjet e tyre për ngulitjen e normës letrare dhe përsosjen e mëtejshme të gjuhës së veprave artistike.